

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5941
E mërkurë, 27 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

28 Nëntori i Ismail
Qemalit, Hasan
Prishtinës, Adem Jasharit
dhe Adem Demaçit! 1 FAQE 3

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**BERISHA: FSK-ja ËSHTË
E GATSHME PËR RUAJTJEN E
PAQES, TË SIGURISË DHE TË
DEMOKRACISË NË BOTË F. 2**

**NË GJEMANI JETOJNË 37 % E
EMIGRANTËVE KOSOVARË, NË
ZVICËR MBI 29 % F. 2**

**KOSOVA, NDËR VENDET
LIDERE PËR PËRDORIMIN
E ANTIBIOTIKËVE F. 8**

**GËRMIMET PËR VARREZË
MASIVE NË PRISHTINË
VAZHDOJNË EDHE SOT F. 7**

EKONOMI

**KONVENTA E BIZNESEVE TË
DIASPORËS, URË LIDHËSE NË
MES TË AFARISTËVE VENDORË
DHE MËRGATËS F. 9**

KULTURË

**LIBËR DËSHMI PËR
TË BURGOSURIT POLITIKË
SHQIPTARË NË JUGOSLLAVI F. 17**

Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA




SPORT

**SPORTISTËT SOLIDARIZOHEN
ME SHQIPËRINË F. 16**

DHJETËRA TË VDEKUR DHE QINDRA TË LËNDUAR NGA TËRMETI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

TËRMETI NË SHQIPËRI SHNDËRROI FESTËN E 28 NËNTORIT NË TRAGJEDI

E mërkura,
ditë zie në
Kosovë



Mbi 21 persona kanë humbur jetën, në mesin e tyre edhe dy vëllezër nga Komuna e Gjilanit dhe mbi 600 të tjerë janë lënduar nga tërmeti i fuqishëm me magnitudë 6.4 ballë të Rihterit që goditi Shqipërinë në orët e hershme të së martës e që është përcjellë edhe me disa tërmete të tjera me fuqi më të vogël. Tërmeti e kishte epiqendrën në Detin Adriatik, 40 kilometra larg kryeqytetit, Tiranës dhe 10 kilometra në

veri të Durrësit. Rreth 40 persona janë shpëtuar deri më tani nga rrënojat në Durrës dhe Thumanë. Lëkundjet e këtij tërmeti dhe të tërmeteve të tjera pasuese janë ndërë fort edhe në Kosovë. Institucionet e Kosovës dhe qytetarë të shumë janë mobilizuar për t'i ndihmuar vëllezërit nga Shqipëria. Gjithashtu, edhe shtetet e tjera nga rajoni kanë ofruar ndihmë për Shqipërinë

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gjeloshaj: Me Tuzin, faktori politik shqiptar tregoi peshën e vet

Tuz, 26 nëntor - Pas tri dekadash përpjekjesh, Tuzi u bë komunë me kompetenca të plota në Mal të Zi dhe në zgjedhjet e marsit për herë të parë forcat politike shqiptare fituan shumicën në Kuvendin Komunal. Nik Gjeloshaj u zgjodh kryetar i komunës së pavarur. Gjeloshaj tha në një intervistë për "Zërin e Amerikës" se fitorja e statusit të komunës me kompetenca të

plota ishte një rezultat i punës së pareshtur të forcave politike shqiptare, bashkimit të këtij faktori dhe kontributit të diasporës. "E ardhmja e Tuzit është të qeveriset nga shqiptarët, forcat politike shqiptare dhe u dërgua një mesazh shumë i qartë për të gjithë shqiptarët kudo që ishin që në Tuz flitet dhe do të flitet sërish shqip", tha ai. Gjeloshaj tha se që kur partitë

shqiptare fituan shumicën, është punuar për krijimin e kornizës ligjore, institucioneve lokale, është miratuar buxheti dhe statuti për komunën. Kryetari i komunës tha se viti 2020 do të jetë vendimtar për rezultate konkrete që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetesës, infrastrukturës, tërheqjen e investimeve dhe hapjen e vendeve të punës. Ai tha se Tuzi

ka treguar vullnetin për të bashkëpunuar me Podgoricën dhe do të vazhdojë ta bëjë një gjë të tillë. "Komuna jonë është komunë evropiane dhe do të integrohet bashkë me Podgoricën dhe Malin e Zi në Bashkimin Evropian dhe në këtë drejtim besoj se do ta vazhdojmë këtë komunikim të mirë të miqësisë dhe i sigurt se do të vazhdojmë kështu për interes të



qytetarëve tanë dhe shteteve dhe rajonit ku jetojmë", tha Gjeloshaj.

Në Gjermani jetojnë 37 % e emigrantëve kosovarë, në Zvicër mbi 29 %

Sipas të dhënave të paraqitura nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, del se në Gjermani jetojnë 37 për qind e emigrantëve kosovarë, kurse në Zvicër mbi 29 për qind. Vitet e migrimit me frekuencën më të madhe janë prej vitit 1990 deri në vitin 1995



PRISHTINË, 26 NËNTOR - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) ka publikuar rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës nëpër shtete, sipas ndarjes territoriale e administrative. Sipas të dhënave të cilat i prezantoi Kadri Sojeva, del se në Gjermani jetojnë 37 % e emigrantëve kosovarë, kurse në Zvicër mbi 29 %.

Vitet e migrimit me frekuencën më të madhe janë prej vitit 1990 deri në vitin 1995. Hulumtimi i të dhënave është bërë me 400 mijë të anketuar. Qëndresa Fazliu, zyrtare për informim në Ministrinë e Diasporës, ka bërë me dije se kanë filluar regjistrimin që nga viti 2014, kurse nga viti 2017 regjistrimi është bërë në mënyrë elektronike. "Ministria e Diasporës ka filluar regjistrimin prej vitit 2014. Që nga viti 2017 regjistrimi është bërë në mënyrë elektronike", tha ajo.

Zëvendësministri i Diasporës, Isni Kilaj, u bëri thirrje të gjithë

shqiptarëve të diasporës të regjistrohen sepse, sipas tij, ata i duhen vendit për të gjitha çështjet. Ai ka shtuar se edhe në zgjedhjet e fundit ka pasur problem sa i përket mosregjistrimit të diasporës. "Është shumë me rëndësi që ne të kemi një regjistër të tillë sepse asnjëherë deri sot nuk kemi pasur një numër të përafërt për të gjithë shqiptarët që jetojnë në diasporë sepse kemi pasur një migrim të madh. Është me rëndësi që ne si komb të kemi një numër të përafërt të të gjithë shqiptarëve", tha ai. "Sot me këtë punë e kemi bërë shumë të lehtë regjistrimin e shqiptarëve në diasporë. Bëjmë thirrje që të gjithë shqiptarët e diasporës të regjistrohen sepse ata na duhen për të gjitha çështjet si për popullsi, po ashtu edhe për aktivitete të tjera. Edhe në zgjedhjet e fundit kemi pasur probleme me regjistrimin", tha Kilaj.

Profesori i demografisë, Rifat Blakaj, tha se ky projekt duhet të

vazhdohet nga qeveria e ardhshme deri në vitin 2021. "Sot bëhet prezantimi që paraqet një ngjarje të rëndësishme kur kemi parasysh që Kosova me numrin e popullsisë ka normat më të larta në shkallën evropiane për shkak të

kaluarës historike. Këto sjellin shumë të dhëna statistikore të besueshme dhe të matshme. Ky është projekti i parë institucional në nivel republike që duhet të mbështetet edhe nga qeveria e ardhshme dhe të vazhdojë deri në vitin 2021. Për

shkak të kaluarës sonë të pafat gjendej jashtë vendlindjes së tyre. Duhet të krijohen kushte, se vetëm ashtu mbyllet rrethi migrues. Ky hulumtim i Ministrisë së Diasporës është studimi më i plotë dhe më i besueshëm", tha Blakaj.

Daçiq: Dialogu nuk vazhdon derisa të hiqet taksa

BEOGRAD, 26 NËNTOR - Shefi i diplomacisë serbe, Ivica Daçiq, ka thënë se nuk mund të ketë vazhdim të dialogut Kosovë - Serbi derisa bashkësia ndërkombëtare nuk i bën presion Prishtinës dhe derisa nuk hiqet taksa ndaj mallrave serbe.

I pyetur lidhur me paralajmërimet për emërimin e një përfaqësuesi të posaçëm evropian për dialogun midis Kosovës

dhe Serbisë, Daçiqi tha se "është shefi i ardhshëm i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, është ai i cili duhet të jetë në vendin e përfaqësuesit evropian dhe se ai do të jetë kryesori". "E gjithë historia e një përfaqësuesi special për dialog në lidhje me Ballkanin Perëndimor u iniciua nga pakënaqësia në disa vende evropiane, para së gjithash në Gjermani, për mënyrën siç ka punuar Federika

Mogerini", tha Daçiqi kur u pyet nëse ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Miroslav Lajçak do të jetë përfaqësuesi i posaçëm, ka njoftuar rre. Megjithatë, sipas Daçiqit nëse do të ketë një përfaqësues të posaçëm, atëherë ai me siguri do të jetë ndonjë ish-kryeministër ose shef i diplomacisë së ndonjë vendi të BE-së.

Shtetet e Bashkuara, më 4 tetor,

emëruan ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, si të dërguar presidencial për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Dialogu është ndërprerë në nëntor të vitit të kaluar, pasi autoritetet në Kosovë vendosën taksë ndaj mallrave serbe, si kundërpërgjigje ndaj një fushate të Beogradit për pengimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare.



Mbahet konferenca "FSK-ja dhe partnerët 2019"

Berisha: FSK-ja është e gatshme për ruajtjen e paqes, të sigurisë dhe të demokracisë në botë



"FSK-ja, me kapacitetet e tanishme, është e gatshme t'i përkrahë partnerët dhe aleatët tanë të NATO-s për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe demokracisë, gjithkund në botë, sa herë që partnerët dhe aleatët tanë kanë nevojë për përkrahjen tonë. Të gjitha të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta dhe kjo histori suksesi është e Kosovës dhe e partnerëve tanë", ka thënë ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, në punimet e sesionit vjeshtor të konferencës "FSK-ja dhe partnerët 2019"

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Në Ministri të Mbrojtjes, nën organizimin e Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Euroatlantike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Departamentit të Planifikimit të Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, të martën u zhvilluan punimet e sesionit vjeshtor të Konferencës "FSK-ja dhe partnerët 2019". Në këtë konferencë morën pjesë ambasadorë dhe atashe të mbrojtjes nga vendet partnere si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Shqipëria, Kroacia, Italia, Turqia, Franca, Holanda, Belgjika, Çekia, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi dhe për herë të parë edhe Jordania. Në hapje të konferencës morën

pjesë ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, zëvendësministri i Mbrojtjes, Kadri Kastrati, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci, drejtori i Ekipit Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës i NATO-s, gjeneralbrigade Michael Oberneyer, si dhe oficerë dhe zyrtarë të tjerë të lartë të FSK-së, KFOR-it dhe NALT-it. Konferencën e hapì ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, i cili theksoi rëndësinë e veçantë të konferencës, duke pasur parasysh periudhën intensive të aktiviteteve përmblylëse të vitit të parë të tranzicionit. Duke e vlerësuar si vit të suksesshëm, ministri Berisha ka thënë se një ndër objektivat e kësaj konference është mbajtja dhe avancimi i partneritetit

dhe dialogut në mes të FSK-së dhe partnerëve, në udhëtimin e përbashkët gjatë fazës së tranzicionit. Ai më pas ka njoftuar të pranishmit me të arriturat kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, me të arriturat konkrete gjatë periudhës përkatëse duke, theksuar se këto të arritura i atribuohen mbështetjes së madhe të partnerëve tanë dhe bashkëpunimit të thellë dypalësh me ta. "FSK-ja me kapacitetet e tanishme është e gatshme t'i përkrahë partnerët dhe aleatët tanë të NATO-s për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe demokracisë, gjithkund në botë, sa herë që partnerët dhe aleatët tanë kanë nevojë për përkrahjen tonë. Të gjitha të arriturat e FSK-së janë suksese të përbashkëta dhe kjo histori suksesi është e Kosovës dhe e

partnerëve tanë", ka thënë ministri Berisha, duke i falënderuar shtetet partnere, në krye me ShBA-në, NATO-n për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë dhe vazhdojnë ta japin për zhvillimin e FSK-së. Drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Michael G. Oberneyer, në fjalën e tij përshëndetëse ka shprehur kënaqësinë që udhëheq Ekipin Këshillëdhënës dhe Ndërlidhës të NATO-s në shërbim të zhvillimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, duke vlerësuar periudhën e organizimit të konferencës si mundësi e mirë për t'i bashkërenduar aktivitetet e planit vjetor 2020 të NALT-it me planin vjetor 2020 të FSK-së. Gjithashtu, në një prezantim të veçantë u paraqit edhe Strategjia e NALT-it 2020-2022, ku përfshihen objektivat, detyrat, sfidat, struktura, niveli i angazhimit si dhe qasja këshilluese e NALT-it për FSK-në. Në vazhdim gjeneral Oberneyer siguroi se mbështetja e NALT-it do të vazhdojë edhe më tej dhe falënderoi udhëheqjen e FSK-së për bashkëpunim si dhe uroi për sukseset e deritashme edhe pjesëmarrësit e Konferencës.

Në vazhdim të punimeve të Konferencës, sipas agjendës së përcaktuar nga oficerët e FSK-së, kolonel Hasan Hoxha, kolonel Haki Hoti dhe major Dedë Hyseni paraqitën prezantimet: Bashkëpunimi ndërkombëtar, Procesi i tranzicionit të FSK-së dhe Plani vjetor 2020 me projeksionet edhe për periudhën 2021-2023. Në sesionin e pasdites përfaqësuesit e delegacioneve nga vendet partnere prezantuan aktivitetet e realizuara të planeve të bashkëpunimit dypalësh me FSK-në për vitin 2019 dhe aktivitetet kryesore të planifikuara në planet e vitit 2020. Për t'i finalizuar punimet e konferencës, në delegacione të ndara u realizuan takime dypalëshe veç e veç ndërmjet delegacioneve të FSK-së dhe delegacioneve të vendeve partnere. Në këto takime u analizuan dhe vlerësuan fushat në të cilat nevojitet mbështetja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së për zhvillimin e aftësive për periudhën trevjeçare dhe u finalizuan planet dypalëshe për vitin 2020 dhe hartimi i konceptplanit për periudhën 2021-2023.

Haradinaj thotë se nuk është takuar me Thaçin për emërimet në AKI



Prishtinë, 26 nëntor - Kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ka thënë se ka ushtruar funksionin dhe kompetencat e veta për ta emëruar drejtorin e AKI-së dhe Inspektorin e Përgjithshëm të këtij institucioni. "I qëndroj mbrapa vendimit që kam marrë me vetëdije të plotë", ka thënë Haradinaj të martën në një konferencë për media. Haradinaj dy ditë më parë ka njoftuar se për drejtor të AKI-së ka emëruar Kreshnik Gashin dhe në pozitën e inspektorit, Burim

Ramadinan. Ai këtë ka thënë se e ka bërë në bashkërendim të plotë me presidentin Hashim Thaçi. Por të martën në konferencë për media, Haradinaj ka theksuar se nuk ka zhvilluar takim me Thaçin për këtë. "Për emërim nuk është obligues të jenë edhe presidenti edhe kryeministri. Obligues është nënshkrimi. E kam dhënë besimin tim dhe këtë e ka bërë edhe presidenti. Nuk kemi mbajtur takim. Nuk është obligues takimi. Pra, nuk ka ndodhur takimi", është shprehur Haradinaj, duke

bërë me dije se me presidentin Thaçi nuk kanë takime bilaterale tash e një kohë. Sa i përket emërimit të Burim Ramadanit që vjen nga AAK-ja, parti të cilën e drejton Haradinaj, ai është përgjigjur: "Jam i gëzuar që është Burimi për shkak të aftësive të tij. Është kadri më i mirë që kam mundur ta gjej në Kosovë. Është më i miri që ka Kosova në atë fushë. Nuk shërben si partiak. Shërben si profesionist. Një pjesë e njerëzve jetojnë me kritikën, por disa të tjerë duhet të punojnë".

Dhjetëra të vdekur dhe qindra të lënduar nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë

Tërmeti në Shqipëri shndërroi fe

Mbi 21 persona kanë humbur jetën, në mesin e tyre edhe dy vëllezër nga Komuna e Gjilanit dhe mbi 600 të tjerë janë lënduar nga tërmeti i fuqishëm me magnitudë 6.4 ballë të Rihterit që goditi Shqipërinë në orët e hershme të së martës e që është përcjellë edhe me disa tërmete të tjera me fuqi më të vogël. Tërmeti e kishte epiqendrën në Detin Adriatik, 40 kilometra larg kryeqytetit, Tiranës dhe 10 kilometra në veri të Durrësit. Rreth 40 persona janë shpëtuar deri më tani nga rrënojat në Durrës dhe Thumanë. Lëkundjet e këtij tërmeti dhe të tërmeteve të tjera pasuese janë ndierë fort edhe në Kosovë. Institucionet e Kosovës dhe qytetarë të shumë janë mobilizuar për t'i ndihmuar vëllezërit nga Shqipëria. Gjithashtu, edhe shtetet e tjera nga rajoni kanë ofruar ndihmë për Shqipërinë



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Mbi 21 persona kanë humbur jetën, në mesin e tyre edhe dy vëllezër nga Komuna e Gjilanit dhe mbi 600 të tjerë janë lënduar nga tërmeti i fuqishëm me magnitudë 6.4 ballë që goditi Shqipërinë në orët e hershme të së martës. Tërmeti i parë i fuqishëm me magnitudë 6.4 ballë të Rihterit goditi Shqipërinë rreth orës 03:50 dhe kishte epiqendrën në Detin Adriatik, 40 kilometra larg Tiranës dhe 10 kilometra në veri të Durrësit. Lëkundjet e tjera më të lehta janë ndierë pas tij. Një tjetër tërmet i fuqishëm është regjistruar në orën 7:10, me magnitudë 5.4. Tërmet me magnitudë prej 5 u shënua edhe në orën 14:10. Lëkundjet e këtij tërmeti dhe tërmeteve të tjera pasuese janë ndierë fort edhe në Kosovë. Si pasojë e tërmetit janë shkatërruar shumë ndërtesa, dhjetëra familje kanë mbetur nën rrënoja. Që nga orët e mëngjesit qytetarët dhe ekipet e shpëtimit kanë tentuar t'i ndihmojnë banorët e bllokuar.

Vetëm gjatë ditës së martë ekipet e shpëtimit mbi 40 persona kanë shpëtuar nga rrënojat në Durrës dhe Thumanë.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, në mëngjesin e së martës ka vizituar Spitalin e Traumës në Tiranë, në të cilin kanë marrë ndihmën dhjetëra persona të lënduar nga tërmeti i fuqishëm. "Dua ta falënderoj personelin mjekësor këtu që është në gatishmëri të plotë. Të gjithë duhet të bëjmë detyrën, pasi Shqipëria është e tronditur shumë rëndë", ka thënë Meta. Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili ka dalë në terren, ka shkruar në "Twitter" se të gjitha strukturat e shtetit janë duke punuar intensivisht për të shpëtuar çdo jetë. "Goditja e fuqishme e tërmetit ka krijuar pasojë të rënda dhe, fatkeqësisht, kemi jetë të humbura. Të gjitha strukturat e shtetit janë në këmbë qysh në çastet e para pas goditjes. Punohet intensivisht për të shpëtuar çdo jetë të mundshme në disa pika fatale në Durrës e Thumanë. Është një moment dramatik. Sidoqoftë, duhet ta ruajmë me çdo kusht qetësinë, të

qëndrojmë pranë njëri-tjetrit e ta përballojmë këtë goditje së bashku. Ne do të bëjmë gjithçka kemi në dorë dhe me miqtë e mëdhenj në krah do ta kalojmë edhe këtë situatë", ka shkruar Rama.

Ndërkohë, ekipe të shpëtimit nga të gjitha vendet e rajonit janë nisur për në Shqipëri për t'i dalë në ndihmë vendit. Njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës u janë bashkuar autoriteteve në Shqipëri në operacionet e kërkim-shpëtimit. Gjithashtu, misionet e huaja të emergjencave civile nga Gjermania, Italia, Franca, Zvicra dhe Greqia kanë filluar të arrijnë

në Shqipëri për ta ofruar ndihmën e tyre. Po ashtu, edhe Mali i Zi dhe Serbia kanë shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar Shqipërinë. Nga Mali i Zi dhe nga Serbia janë nisur dy ekipe të specializuara për shpëtimit në raste katastrofash. Kurse nga Rumania janë nisur dy aeroplanë ushtarakë shpëtimit. Në Shqipëri pritet të mbërrijnë ndihmat edhe nga Turqia.

Pas tërmetit të fuqishëm të mëngjesit të së martës, Ministria e Arsimit e Shqipërisë ka njoftuar se mësimi në mbarë vendin do të ndërpritet për dy ditë. Shqipëria edhe dy muaj më parë është goditur nga një tërmet me magnitudë

5.8 gradë të shkallës Rihter dhe intensitet 7.5 ballë. Ai u konsiderua më i madhi i regjistruar në 20-30 vjetët e fundit. Tërmeti i cili goditi Shqipërinë në mëngjesin e së martës është më i fuqishmi që ka goditur Shqipërinë që nga viti 1926.

Kosova solidarizohet me Shqipërinë, qeveria ndan 500 mijë euro

Lëkundjet e tërmeteve që kanë goditur Shqipërinë janë ndierë fort edhe në Kosovë, gjë që ka bërë që shumë qytetarë të Prishtinës dhe të Fushë-Kosovës të dalin nga



stën e 28 Nëntorit në tragjedi



Shqipërisë i del në ndihmë edhe Evropa

Pas fatkeqësisë së tërmetit në Shqipëri, Bashkimi Evropian ka reaguar zyrtarisht përmes Federica Mogherinit, zëvendëspresidente e BE-së dhe zyrtare e lartë për Politikën e Jashtme dhe Siguri. Edhe presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, ka reaguar për situatën e rëndë në Shqipëri. Në një postim në rrjetet sociale, Sassoli ka deklaruar se i gjendet pranë popullit shqiptar në këtë situatë të vështirë. "U gjendem pranë vëllezërve dhe popullit shqip-

tar. Evropa është me ju", ka shkruar Sassoli.

Edhe ish-kancelari austriak Sebastian Kurz ka shprehur ngushëllimet e tij për viktimat nga tërmeti. "Mendimet dhe lutjet e mia janë me popullin e Shqipërisë, veçanërisht me familjet e viktimave të tërmetit të natës së kaluar. Ne jemi të gatshëm për ta ndihmuar Edi Ramën", ka shkruar Kurz në "Twitter".

Ngushëllime për Shqipërinë kanë ardhur edhe nga shumë liderë evropianë.

motrave shqiptare, si dhe familjarëve të viktimave të këtij tërmeti, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta dhe shpreh gatishmërinë më të lartë për mbështetje dhe solidaritet", ka thënë presidenti Thaçi.

Edhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se me shqetësim po i përcjell lajmet për tërmetet e njëpasnjëshme që goditën Shqipërinë dhe një pjesë të Kosovës gjatë natës. "Mendimet dhe lutjet e mia janë me të gjithë qytetarët që pësuan dhe ata që presin me pa durim lajme për familjarët e tyre. Kosova është e gatshme t'i ofrojë ndihmën e saj të pakursyer popullit dhe shtetit të Shqipërisë për ta tejkaluar këtë situatë të rëndë. Të gjithë të lënduarve shërim sa më të shpejtë dhe për ata që pësuan do të jemi në dispozicion të plotë", ka shkruar Haradinaj.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se është tejet i pikëlluar me jetët e humbura nga pasojat e tërmetit që goditi Shqipërinë. "Mendjet dhe zemrat tona janë me familjet që kanë humbur më të dashurit dhe të gjithë qytetarët e Shqipërisë që po kalojnë këto çaste të vështira. Kosova do të japë çdo mbështetje për Shqipërinë për ta kaluar bashkë këtë dhembje", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se edhe Kosova ka përjetuar

këtë dhembje. "U ndie shumë edhe në Prishtinë. U zgjuam të gjithë. Por, tash mendjen, sytë dhe veshët i kemi te Durrësi, te Kurbini e Thumana. Ngushëllime familjeve të viktimave dhe shërim të plagosurve e të lënduarve! Lutemi e urojmë që të mos përsëritet tërmeti. Kosova e përjeton dridhjen dhe dhimbjen e Shqipërisë. Jemi të gatshëm t'u ndihmojmë autoriteteve zyrtare për çdo gjë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se i ka telefonuar presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, pas tërmetit që ka përfshirë shtetin shqiptar. "Të nderuar qytetarë, Shqipëria dhe shqiptarët po përjetojnë një tragjedi të rëndë nga pasojat e tërmetit. I telefonova presidentit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, për t'i shprehur dhembjen dhe solidarizimin tonë me shtetin shqiptar dhe me familjet e viktimave të kësaj fatkeqësie. E urova që sa më shpejt të tejkalohet kjo gjendje me sa më pak viktima njerëzore e materiale dhe për shërim sa më të shpejtë të vëllezërve dhe motrave tona që morën lëndime në këtë fatkeqësi. Fizikisht jemi në Kosovë, por me mendje dhe përjetime, së bashku me ju në Shqipëri", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se tërmetet e njëpasnjëshme që goditën Shqipërinë mbrëmë dhe mëngjesin e së martës kanë shqetësuar të gjithë shqiptarët. "Në këto çaste të rënda lutjet tona janë për vëllezërit dhe motrat tona që pësuan nga tërmeti i fuqishëm që goditi Shqipërinë", ka shkruar Limaj.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka konfirmuar se FSK-ja ka dërguar ushtarë në Shqipëri për t'u dalë në ndihmë lidhur me tërmetin që ka tronditur vendin mëngjesin e sotëm.

Vijon në faqen 6



banesat e tyre. Me të kuptuar se epiqendra e këtij tërmeti ka qenë në Shqipëri, institucionet e Kosovës kanë dhënë urdhër për nisjen e menjëhershme njësisë së kërkim-shpëtimit të Gardës Kombëtare të Kosovës për në zonat e prekura nga tërmeti. Gjithashtu, Shqipërisë i kanë dalë në ndihmë edhe njësitet e Policisë së Kosovës.

Të martën është mbledhur edhe Qeveria e Kosovës në dorëheqje e cila ka ndarë 500 mijë euro ndihmë për Republikën e Shqipërisë. Ndërsa lidhshipi politik i Kosovës u ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të viktimave. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i ka dërguar një telegram ngushëllimi Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, për viktimat e tërmetit në Shqipëri. "Në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim, juve, vëllezërve dhe

E mërkura, ditë zie në Kosovë

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka shpallur të mërkurën, datë 27 nëntor 2019, ditë zie në Kosovë, në nderim të viktimave që humbën jetën nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë. "Në shenjë respekti shtetëror dhe qytetar, dita e mërkurë, 27 nëntor 2019, shpallet ditë zie shtetërore në Republikën e Kosovës, pas tërmetit në Shqipëri, i cili la dhjetëra persona të vdekur dhe shumë të lënduar", thuhet në vendimin e presidentit Thaçi. Me vendim të presidentit Thaçi, flamuri shtetëror ngritet në gjysmështizë në të gjitha objektet shtetërore të Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë vendit.



Vijon nga faqja 5

Gjeneralletnënt Rama ka thënë se nëse është nevoja, FSK-ja është e gatshme të përkrahë Shqipërinë edhe me trupa dhe pajisje shtesë. "Qysh në mëngjes herët jemi në kontakt me autoritetet e Shqipërisë atje, por edhe me Ushtrinë e Shqipërisë dhe kemi marrë informacion se

gjendja është alarmante për shkak të dridhjes së tokës që ka ndodhur në Shqipëri. Bazuar në kërkesën e tyre që e kanë drejtuar drejt nesh, i kemi nisur trupat tanë. I kemi nisur njësitë e kërkim-shpëtimit urban që janë të specializuara dhe të pajisura mirë, duke marrë për bazë edhe njësinë me 'K9' ose me qen që janë të specializuar për kërkim

urban nën gërmadha, por i kanë edhe pajisjet e tjera. Normalisht, pas vlerësimit të situatës të trupave tona atje, nëse është nevoja, jemi të gatshëm t'i përkrahim edhe me trupa shtesë dhe pajisje shtesë", ka thënë Rama.

Ngushëllime kanë shprehur edhe liderët e tjerë të partive politike në Kosovë.

Në Kosovë nuk ka munguar as solidariteti qytetar për të mbledhur ndihma për familjet e prekura nga tërmeti në Shqipëri. Organizata e Veteranëve të UÇK-së ka ndarë 5 000 euro për Shqipërinë në shenjë solidariteti me popullin shqiptar pas tërmetit. Grupe të ndryshme të tifozëve, grupe politike dhe qytetarë të thjeshtë kanë bërë pika grumbulluese nëpër qytetet të ndryshme të Kosovës për të mbledhur ndihma të shpejta për shqiptarët me sloganin "Pray for Albania". Gjithashtu, shumë qytetarë nëpër rrjete sociale kanë shkruar se kanë hapur dyert e shtëpive të tyre për shqiptarët që kanë mbetur pa strehë mbi kokë nga tërmeti. Ndërkaq, dhjetë mijë litra naftë për automjetet e Policisë së Kosovës dhe për ato të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka dhënë kompania "Hib Petrol".



Shqipëria, lajmi i parë në mediat e huaja

Shqipëria ka qenë lajmi i parë në mediat ndërkombëtare, si "New York Times", "CNN", "BBC", "Reuters" dhe "Dailymail". Tërmeti i magnitudës 6.4, shkruan "New York Times", është një ndër më të fuqishmit në dekada që trondit Shqipërinë. Në artikull përmenden viktimat, kaosi e frika që ka mbjellë në vendin tonë furia e natyrës. Shkatërrim dje panik raporton "The Guardian", që e përshkruan situatën me tone dramatike. Në mënyrë të veçantë, e përditshmja prestigjioze angleze citon rastin e gruas së moshuar në

Durrës që nuk arriti të mbijetonte, por shpëtoi nipin duke e mbuluar me trupin e vet. "CNN" citon Institutin Gjeologjik Amerikan, duke theksuar se epiqendra e tërmetit ka qenë në një thellësi prej gati 20 kilometrash. Gjithashtu, e përmend mbylljen e shkollave në tri qytete, Durrës, Tiranë dhe Lezhë. Banorët nën rrënoja, shkruan "Reuters". "Po luftohet me kohën për gjetjen e të mbijetuarve", shkruan "Foxnews", duke shtuar se ekipet e shpëtimit u kanë ardhur në ndihmë banorë vendës.

Diskutohet për rolin e prokurorëve në politikën ndëshkimore

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Me iniciativë të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë dhe në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit është mbajtur tryezë diskutimi për rolin e prokurorëve në aplikimin e politikës ndëshkimore gjatë procedurave gjyqësore. Në hapje të takimit, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka deklaruar se qëllimi i kësaj tryeze është diskutimi për aplikimin e udhëzuesit të politikës ndëshkimore nga ana e gjykatave dhe për rolin e prokurorëve për krijimin e një politike unifikuese ndëshkimore.

Në këtë kontekst është kërkuar një rol më aktiv nga ana e prokurorëve që nëpërmjet

veprimeve juridike të ndikojnë te gjykatat për shqiptimin adekuat të sanksioneve penale. "Ne si prokurorë duhet të kërkojmë nga gjyqtarët që të shqiptohen dënime adekuate në harmoni me peshën e veprës penale. Prokurorët duhet të sigurojnë aktakuzat të fuqishme të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike, me anë të së cilës bëhet edhe cilësimi i duhur juridik i veprës penale", ka deklaruar kryeprokurori Lumezi.

Gjatë kësaj tryeze, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha niveleve të sistemit prokurorial, është diskutuar edhe për përdorimin e procedurave alternative nga ana e prokurorëve, të drejtën e



ankimimit, rolin mbikëqyrës dhe bashkëpunues ndërmjet kryeprokurorëve dhe prokurorëve gjatë kualifikimit të veprave penale, krijimin e një mekanizmi që mundëson një bashkëpunim me institucionet, siç janë: shërbimi sprovues, shërbimet sociale, si

dhe tema të tjera të cilat ndërlihen me natyrën e këtij takimi.

Po ashtu, gjatë diskutimeve ndërmjet përfaqësuesve të institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe partnerëve nga Ambasada e ShBA-së në Prishtinë është parë e nevojshme

hartimi i një udhëzuesi për rolin e prokurorëve në politikën ndëshkimore, me ç'rast është caktuar edhe grupi punues i cili do të punojë për hartimin dhe përgatitjen e këtij udhëzuesi, që do të jetë në harmoni me udhëzuesin e politikës ndëshkimore të hartuar nga Gjykata Supreme dhe ligjet e tjera në fuqi.

Pjesëmarrës në këtë tryezë nga Ambasada Amerikane në Prishtinë ishin Këshilltarët e Lartë Ligjorë, Lana Owens dhe Corey Smith, njëherësh prokuror Federal në Distriktin e Floridës në ShBA, i cili ka shprehur gatishmërinë për të diskutuar dhe bashkëpunuar për çështjet që janë në interes të institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Shërbimi Korrektues i Kosovës shënon 20-vjetorin e themelimit

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, ka thënë se qëllimi dhe vizioni i këtij shërbimi është që në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurisë në vend të kontribuojnë për një shoqëri më të sigurt nëpërmjet zbatimit me efektivitet dhe human të vendimeve gjyqësore për personat që kanë rënë ndesh me ligjin

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Të martën është shënuar 20-vjetori jubilar i themelimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), në të cilin kanë marrë pjesë kryeministri Ramush Haradinaj, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Rashit Qalaj, përfaqësuesja nga Ambasada e Amerikës në Kosovë, Jessica Long, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve të Republikës së Shqipërisë, Agim Ismajli dhe drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve të Malit të Zi, Milan Tomiq. Në fillim të ceremonisë së shënimit të këtij përvjetori u mbajt një minutë heshtje në nderim të viktimave të tërmetit që preku gjatë natës territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se ky është një moment shumë i rëndësishëm për t'i thënë disa fjalë në shenjë vlerësimi për këtë institucion. "Shpreh falënderimin në emër të Qeverisë së Kosovës për angazhimin vërtet të mirë e profesional të të gjithë juve në punën tuaj të përditshme e që është një punë sfiduese, por edhe një punë e rëndësishme së lartë për vendin tonë, shoqërinë tonë, rendin dhe ligjin. Sundimi i ligjit është prioritet i qeverisë në vend dhe vazhdon të mbetet i këtyllë", tha kryeministri në detyrë Haradinaj duke vlerësuar se angazhimi për të ndërtuar një qeverisje demokratike, gjithëpërfshirëse dhe efektive që do t'i shërbejë popullit të

Kosovës pa diskriminim, fillon me sundim të fortë të ligjit. Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri në detyrë, Haradinaj, shtoi se sistemi i sundimit të ligjit në Kosovë e ka Shërbimin Korrektues si një nga hallkat shumë të rëndësishme dhe shumë të ndjeshme dhe se Shërbimi Korrektues nga fillimi e deri më sot është profesionalizuar dhe ka arritur standard të shërbimeve korrektuese euro perëndimore. "Sot kemi programe të punës gjatë vuajtjes së dënimit, të ngritjes profesionale, rehabilitimit të të burgosurve dhe përkrahjes pas dënimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka rritur buxhetin për institucionet e rendit dhe ligjit, njëkohësisht të drejtësisë që prek edhe Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ka bërë investime në infrastrukturë, ka rritur numrin e personelit, në këtë rast të gardianëve me 100 gardianë të ri, ka rritur pagat në nivel me institucionet e tjera dhe kjo qasje e qeverisë siguron shërbim të pavarur dhe modern", veçoi kryeministri në detyrë, Haradinaj.

Në përfundim të fjalës, duke ua uruar përvjetorin e 20 dhe punë të suksesshme, kryeministri në detyrë, Haradinaj, tha se ajo që sot është sfidë e re, është edhe përhapja e ideve dhe rreziqeve të ekstremizmit në kuadër të vuajtjes së dënimit që kërkon një vëmendje të posaçme në kohën e re dhe kërkon aftësi të veçanta.

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, ka thënë

se qëllimi dhe vizioni i këtij shërbimi është që në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurisë në vend të kontribuojnë për një shoqëri më të sigurt nëpërmjet zbatimit me efektivitet dhe human të vendimeve gjyqësore për personat që kanë rënë ndesh me ligjin. "Vizioni ynë është që të ofrojmë trajtim të barabartë, human për të gjithë të burgosurit në mënyrë që të risocializohen përmes programeve rehabilituese, aftësimeve profesionale, punës dhe aktiviteteve sportive dhe kulturore", ka thënë Thaçi. Më tej, ai tha se pas luftës edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës ka pasur vështirësitë e veta, por falë mbështetjes nga qeveria, institucioneve ndërkombëtare dhe përkushtimit të të gjithë zyrtarëve, sot është kompletuar infrastruktura në të gjitha institucionet korrektuese dhe janë krijuar kushte të banimit për të burgosurit sipas standardeve ndërkombëtare.

Ndërsa ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka vlerësuar se kjo agjenci ekzekutive e MD-së ka qenë ndër shtyllat e para të sigurisë në Kosovën e pas luftës dhe se ky vit jubilar e gjen Shërbimin Korrektues më të kompletuar se kurrë, duke u bërë kështu konkurrent me institucionet homologe të vendeve të rajonit. "Krahas Policisë, Shërbimi Korrektues ka qenë një ndër shtyllat e para të sigurisë në Kosovën e pas luftës. Një ndër institucionet e para të mendësisë së re demokratike, që ka respekt për të drejtat e njeriut dhe që siguron rendin duke zbatuar standardet e integritetit", ka deklaruar Tahiri. Në fund të ceremonisë ministri Tahiri dhe Thaçi kanë ndarë mirënjohje dhe dekorata për të gjithë partnerët dhe zyrtarët korrektues të cilët kanë kontribuar për zhvillimin dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës gjatë këtyre 20 vjetëve.



Gërmimet për varrezë masive në Prishtinë vazhdojnë edhe sot

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Autoritetet përgjegjëse në Kosovë i kanë ndërprerë të martën gërmimet për një varrezë të dyshuar masive me mbetjet mortore të personave të zhdukur gjatë luftës së fundit. Kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur, Prenk Gjetaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Policia e Kosovës, konkretisht Njësia për Krime Luftë, bashkë me Prokurorinë dhe Institutin e

Mjekësisë Ligjore, deri më tash nuk kanë hasur në ndonjë mbetje mortore. Ai ka bërë me dije se gërmimet në këtë pjesë do të vazhdojnë edhe sot (e mërkurë).

Gërmimet aty vijnë pas marrjes së informacioneve nga disa qytetarë se në atë lokacion mund të ketë varrezë masive nga periudha e luftës e vitit 1999 në Kosovë. Nga kjo luftë ende mbeten të zhdukur edhe rreth 1 600 persona.



Kosova, ndër vendet lidere për përdorimin e antibiotikëve

Për kah përdorimi i antibiotikëve Kosova vazhdon të cilësohet një ndër shtetet lidere në Evropë. Meqë barnat mund të blihen në çdo farmaci pa përshkrimin e mjekut, shkalla e lartë e përdorimit të antibiotikëve në Kosovë vlerësohet e pakontrolluar



do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjitha spitalet publike, partnerët shëndetësorë, veterinarë dhe mjedisorë për ta ulur rezistencën ndaj antibiotikëve dhe për ta rritur sigurinë shëndetësore të popullatës. Megjithatë, shitja e antibiotikëve ndër vite ka vazhduar me ritëm të njëjtë. Tringa Kelmendi, 28-vjeçare, qytetare nga Prishtina, thotë se antibiotikë mund të blihen në secilën barnatore të Kosovës pa recetë të mjekut dhe pa asnjë pyetje nga ana e farmacistëve se për çka u duhet qytetarëve antibiotiku. "Po, shumë shpesh më ka ndodhur të blej dhe të përdor antibiotikë. Pa vështirësi

në barnatore e blen një antibiotik pa recetë të mjekut. Në secilën barnatore të Kosovës mund të blihen antibiotikë", ka thënë Kelmendi. Sipas një hulumtimi të bërë mes spitaleve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe atyre të Kosovës, ka rezultuar se në spitalet e pediatrikë ku trajtohen fëmijët e moshës nën 18 vjeç antibiotikë marrin 36 për qind e fëmijëve në vendet e BE-së, derisa në Kosovë kjo përqindje arrin në 67 për qind, kanë deklaruar zyrtarë shëndetësorë të kësaj fushe. Ndërkaq farmacistët thonë se antibiotikët vazhdojnë t'i shesin pa recetë të mjekut. Një nga farmacistet, Besa Kadriu, tha se

shpeshherë antibiotiku kërkohet pa arsye dhe me insistim të qytetarëve, siç tha ajo, farmacistët ua shesin. "Po, ka interesim nga qytetarët për blerje të antibiotikëve pa recetë. Ne si farmacistë po mundohemi që të mos i japim pa recetë, po flas për vete. Megjithatë, pacientët insistojnë dhe ne nuk kemi ndonjë vendim që ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë. Zakonisht e kërkohet për grip, ftohje dhe ne ua shpjegojmë se antibiotiku përdoret për infeksioni bakteriale, e jo për virale siç e kërkojnë ata. Por, pacientët dhe qytetarët në përgjithësi janë mësuar ashtu dhe vazhdojnë t'i përdorin pa arsye", është shprehur ajo. Sidoqoftë, Java Botërore e Ndërgjegjesimit për Antibiotikët po shënohet edhe në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka njoftuar se po synon ta rrisë ndërgjegjesimin global për rezistencën anti-mikrobike dhe t'i inkurajojë praktikën më të mirë në mesin e publikut të gjerë, punonjësve shëndetësorë dhe krijuesve të politikave, për ta shmangur shfaqjen e mëtejshme dhe përhapjen e rezistencës anti-mikrobike.

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Përdorimi i shpeshtë dhe në disa raste i panevojshëm i antibiotikëve, sipas profesionistëve shëndetësorë, ka bërë që rezistenca ndaj tyre të konsiderohet sfida kryesore globale e shëndetësisë në shekullin XXI. Ndonëse vitet e fundit është shënuar rënie e shkallës së lartë të përdorimit të tyre, Kosova mbetet kampione në Evropë për përdorimin e grupit të antibiotikëve të njohur si antibiotikë injeksion të cef-reaksionit. Lul Raka, mikrobiolog, njëherësh koordinatori i bashkëpunimit me Qendrën Evropiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, i tha "Radios Evropa e Lirë" se Kosova vazhdon të jetë kampione në Evropë për përdorimin e një lloji të antibiotikut, derisa thotë se suksesi i këtij viti ka qenë vetëdijësimi i stafit shëndetësor, por edhe i popullatës për përdorimin e linjës së parë të antibiotikëve. "Ende

antibiotikët mund t'i blihen pa recetë të mjekut. Shpresoj se do të ketë përsheptim të zbatimit të ligjit, pasi Kosova me ligj e ndalon shitjen pa recetë të antibiotikëve. Ne nuk e dimë me përqindje se sa përdoret antibiotiku, por nga përvoja e njerëzve, përqindja është e lartë, pasi vetë farmacistët i shesin pa recetë. Ne jemi duke punuar me Odën e Farmacistëve dhe besoj se do të kërkojmë alternativa që ta fuqizojmë punën e Inspektoratit Farmaceutik dhe t'i përfshijmë të gjitha instrumentet e shtetit për ta adresuar këtë problem", ka theksuar ai. Kosova ka ligj që e ndalon blerjen e barnave pa recetë, por ky ligj nuk është zbatuar asnjëherë. Në përpjekje që të zbatohet ligji përkatës, i cili ndalon shitjen e barnave pa udhëzim apo recetë të mjekut, në dhjetor të vitit të kaluar Ministria e Shëndetësisë ka miratuar një plan veprimi për 'Rezistencën antimikrobike', i cili



Reformat në kadastrë, takim në mes të AKK-së dhe ZKK-së

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Agjencia Kadastrale e Kosovës, në kuadër të reformave në fushën e kadastrës, ka ndërmarrë disa iniciativa ligjore të cilat kanë rezultuar me ndryshimin e akteve nënligjore, respektivisht hyrjen në fuqi të gjashtë Udhëzimeve Administrative në fushën e kadastrës dhe regjistrimit të pronës, nga të cilat përfitimet për qytetarët do të jenë të menjëhershme dhe do të ndikojnë edhe në kryerjen e

punëve të përditshme nga kompanitë e licencuara gjeodete, gjeodetët e licencuar dhe Zyrat Kadastrale Komunale. Ndërsa me qëllim të prezantimit të Udhëzimeve Administrative si dhe trajtimit të çështjeve të tjera të interesit të përbashkët është mbajtur një takim në mes të ekzekutivit të AKK-së të prirë nga kryeshefi Avni Ahmeti, i shoqëruar nga ekspertë kadastralë dhe ligjorë dhe zyrave kadastrale komunale të përfaqësuar nga drejtorët e zyrave kadastrale, shoqëruar nga zyrtarët ligjorë dhe kadastralë.

Në takim u prezantuan ndryshimet që rrjedhin nga këto udhëzime administrative, me theks të veçantë ato pjesë që afektojnë punën e zyrtarëve nëpër zyrat kadastrale komunale, si: standardizimi i çmimeve për produkte dhe shërbime kadastrale dhe pronësor-juridike, eliminimi i pengesave për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në zonat urbane, ndalesa e punëve në terren për bashkim dhe për ndarje të parcelave për zyrtarët e zyrave kadastrale komunale, krijimi i bazës ligjore për ofrimin e produkteve kadastrale online, thjeshtimi

i procedurave për krijimin e bashkëpronësisë dhe krijimi i bazës ligjore për ndarjen e bashkëpronësisë në rastet kur qytetarët janë obliguar të hyjnë në bashkëpronësi. Përndryshe, diskutimet interaktive rezultuan me një pajtueshmëri në masë të madhe mes zyrtarëve të AKK-së dhe ZKK-ve në lidhje me reformat, ndërsa disa çështje teknike mbeten të zgjidhën përmes bashkëpunimit teknik dhe profesional në mes të institucioneve respektive. Udhëzimet e reja, të nënshkuara nga ministri i Ministrisë së Mjedisit

dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, janë: Udhëzimi Administrativ për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve, Udhëzimi Administrativ për matjet kadastrale për regjistrim në kadastrë, Udhëzimi Administrativ për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, Udhëzim Administrativ për ndarjen e zonave kadastrale, Udhëzimi Administrativ për tarifën e produkteve dhe shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Udhëzimi Administrativ për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës.

Konventa e Bizneseve të Diasporës, urë lidhëse në mes të afaristëve vëndorë dhe mërgatës



PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Për dy ditë me radhë në Prishtinë ka qenë e hapur Konventa e Bizneseve të Diasporës dhe të Huaja, qëllimi i së cilës ishte që të krijojë bashkëpunim në mes të bizneseve të Kosovës, diasporës dhe atyre të huaja, duke i bashkuar në një pikëtakim. Kjo konventë, e cila organizohet për herë të tretë në Kosovë, synon krijimin e marrëdhënieve të reja të partneritetit mes bizneseve pjesëmarrëse dhe të ofrojë mundësi të inte-

grimit në fushën e ekonomisë përmes takimeve B2B.

Kryetari i rrjetit të bizneseve të diasporës shqiptare në Finlandë, Omer Nura, ka thënë se në ditën e dytë të konventës së bizneseve të diasporës dhe të huaja, bizneset vëndore dhe ato të diasporës do t'i shkëmbejnë përvojat e tyre dhe kontaktet në mënyrë që t'i shohin mundësitë e tyre për ndonjë bashkëpunim në të ardhmen. "Punët po ecin për së mbari, ka shumë investitorë, biznese nga

jashtë. Çka është e rëndësishme, janë bizneset e huaja që kanë ardhur, partnerët tanë dhe interesimi është i jashtëzakonshëm sepse të gjithë janë të përgatitur mirë. Sot bizneset vëndore do t'i shkëmbejnë përvojat, t'i shkëmbejnë vizitkartat që të njoftohen mes vete, t'i shohin mundësitë e bashkëpunimit për të ardhmen", u shpreh ai.

Ndërkaq drejtori i kompanisë "Drini", Qamil Isufi, ka thënë se konventat e tilla janë si urë lid-

hëse në mes të bizneseve vëndore dhe atyre të diasporës. "Këto konferenca do të thotë janë urë lidhëse në mes të mërgatës dhe afarizmit të Kosovës, për fat të keq që në Kosovë nuk ka pasur një trajtim të mirëfilltë të mërgatës dhe, po të shikosh realisht, Kosova përfiton nga mërgata çdo ditë", ka deklaruar ai.

Drejtori i kompanisë për prodhimin e lëngjeve, "Laberian", Bashkim Osmani, ka theksuar se kjo konventë për ta si prod-

hues vëndor është shumë e rëndësishme sepse, sipas tij, iu ka afuar mundësi të mëdha për shkëmbin e përvojave të tyre dhe u ka ofruar takime me biznese të reja që nuk kanë pasur mundësi t'i takojnë më herët. "Kjo konventë për si prodhues vëndor është mjaft e rëndësishme sepse një mori e madhe e kompanive të diasporës dhe kompanive të huaja janë sot këtu me ne dhe po zhvillojmë takime me ta", ka thënë Isufi.




AKP-ja shpalli shitjen numër 53 të aseteve përmes likuidimit

PRISHTINË, 26 NËNTOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka shpallur shitjen e aseteve përmes likuidimit numër 53. Lista e tenderëve për privatizim me këtë valë të shitjeve përmban 123 asete/njësi atraktive të ndërmarrjeve shoqërore në

Kosovë të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në vëndin tonë. "Kjo valë e shitjeve me të gjitha asetet e tenderuara është aprovuar në Bordin e Drejtorëve, kurse AKP-ja i ka njoftuar paraprak-

isht të gjitha komunat përkatëse se këto asete të ndërmarrjeve shoqërore do të privatizohen dhe ka shpallur njoftimin për tender në faqen e internetit dhe në mediat e shkruara dhe ato elektronike", thuhet në njoftimin e AKP-së.



Studentët nënshkruajnë kontratat për bursat e ndara nga Komuna e Drenasit



Drenas, 26 nëntor (ER) - Në Sallën e Kulturës në Drenas, studentët përfitues të bursës komunale për vitin akademik 2019/2020, kanë nënshkruar kontratat për marrjen e bursës të ndara nga Komuna e Drenasit. Me rastin e nënshkrimit të kontratave i pranishëm ka qenë edhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Nazmi Hasi si dhe anëtarë të komisionit të cilët kanë bërë vlerësimin e aplikantëve për bursë.

Numri i bursave për këtë vit akademik është 160.

Kryetari Lladrovci para studentëve ka thënë se është shumë i lumtur që 160 studentë të Komunës së Drenasit po nënshkruajnë kontratat për bursa për vitin e ri akademik. Ai ka thënë se nuk do të reshtë që përmes donatorëve, brenda mundësive, të gjejë mënyra për financimin edhe për 40 bursa për studentë sipas listës së publikuar, sipas radhës, pas numrit 160. "Ne nuk jemi komunë e

madhe, por kemi vullnet dhe përkushtim të madh për studentët tanë, të tashmen dhe të ardhmen tonë", ka thënë Lladrovci.

Vlera e bursës komunale për një student është 500 euro dhe me këtë synohet ngritja e cilësisë në arsim. Komisioni në përbërje të anëtarëve profesionalë, pas vlerësimit të aplikacioneve, ka shpallur përfituesit dhe ka renditur ata në bazë të numrit të pikëve sipas kriterëve të konkursit.

Nis legalizimi i objekteve ndërtimore në Komunën e Ferizajt

FERIZAJ, 26 NËNTOR - Që nga java e kaluar në Komunën e Ferizajt ka filluar legalizimi i objekteve ndërtimore. Procedura është fare e thjeshtë, palët që dëshirojnë ta legalizojnë pronën e tyre duhet të kenë fletën poseduese, kopjen e planit, piketimin gjeodezik dhe të paguajnë 1 euro për metër katror për shtëpi banimi dhe 2 euro për metër katror për banim kolektiv. Procedurat e legalizimit janë më të lehta sesa marrja e një leje të ndërtimit thonë zyrtarët komunalë nga



Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Ferizajt. Në komunën e Ferizajt janë rreth 30 mijë objekte që presin legalizimin, procedurat janë të njëjta si për objektet e papërfunduara si për objektet e ndërtuara. (EO)

Organizohet simpoziumi shkencor me temën 'Folklori në Drenicë'

SKENDERAJ, 26 NËNTOR (ER) - Në kuadër të festave të nëntorit është organizuar simpoziumi shkencor "Folklori në Drenicë", ku profesorë të ndryshëm e kanë trajtuar folklorin në mënyrë profesionale. Në hapjen e këtij simpoziumi shkencor ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i cili ka thënë se organizime të tilla janë të dobishme për secilin qytetar. "Ka filluar mbajtja e simpoziumit shkencor me temën 'Folklori në Drenicë', ku profesorë të shquar do ta trajtojnë rolin e kësaj teme me profesionalizëm, të cilët i falën-



derova për kontributin e tyre në këtë organizim. Organizime të tilla të cilat kanë gërshetim me

vlerat tona kombëtare janë të dobishme për secilin qytetar", ka thënë Jashari.

Vazhdojnë punimet për rregullimin e shtratit të lumit 'Ibër' dhe 'Sitnica'

MITROVICË, 26 NËNTOR (ER) - Drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës, Naser Muja, ka dalë në terren për t'i parë nga afër punimet që janë duke u zhvilluar për rregullimin e shtratit të lumit "Ibër" dhe "Sitnica".

Me këtë rast, Muja është shprehur mjaft i kënaqur me dinamikën e punimeve që po

bëhen për rregullimin e shtratit të lumenjve "Ibër" dhe "Sitnica" ku, përveç rregullimit të shtretërve, këto projekte parashihen ta kenë shtegun për këmbësor, hapësira gjelbërimi, ndriçim publik, mure mbrojtëse, ura kaluese apo prag kapërderdhës, i cili do të shërbejë si pushimore. Po ashtu, drejtori Muja ka theksuar se rregullimi i këtyre shtretërve të

lumenjve, përveç aspektit rekreativ, ka rëndësi të madhe edhe në parandalimin e vërshimeve që zakonisht kanë shkaktuar këta lumenj. Këto projekte janë duke u realizuar si bashkëfinansim në mes të Komunës së Mitrovicës si dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Të dy projektet parashihen të kushtojnë rreth 8 milionë euro.



Nis renovimi i ambulancave mjekësore në tetë fshatra të Klinës

KLINË, 26 NËNTOR (ER) - Komuna e Klinës ka filluar projektin për rinovimin e qendrave dhe ambulancave të mjekësisë familjare në tetë fshatra të Klinës, projekt ky i cili është duke u realizuar në kuadër të investimeve komunale për përmirësimin e kushteve infrastrukturore në këto qendra të kujdesit shëndetësor.


Për ta parë nga afër realizimin e punimeve, të martën kryetari i

Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, bashkë me drejtorin e Shëndetësisë, Hekuran Sejdiu, kanë qëndruar në Grabanicë, ku po bëhet rinovimi i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në këtë fshat. Ky projekt kap vlerën prej 47 222 eurosh, ndërsa do të rinovohen ambulanca të kujdesit shëndetësor në këto fshatra: Grabanicë, Zllakuqan, Sferkë, Budisalc, Jagodë, Gllarevë, Jashanicë dhe Caravik.





K. S. “Kosova e re”, në vend të urimit për Ditën e Flamurit, të gjithë shqiptarëve u shpreh ngushëllime me rastin e tragjedisë së ndodhur në Shqipëri.



K. R. U “Prishtina”,
në vend të urimit
për Ditën e Flamurit,
të gjithë shqiptarëve
u shpreh ngushëllime
me rastin e tragjedisë
së ndodhur
në Shqipëri.



Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA_{ERE}

E rrallë

Manastiri mbyllet pasi kryemurgesha bie në dashuri

Një manastir i bukur i shekullit të 17 është detyruar të mbyllet pasi një murgeshë 40-vjeçare, e cila ishte e famshme si person shumë energjik, ishte dashuruar dhe ishte lidhur me një banor të zonës. Konventa e Etërve Kapuçini në Sansepolkro u mbyll përfundimisht, sipas



faqes së tyre të internetit. Murgesha 40-vjeçare që e drejtonte u largua nga manastiri dhe aty kanë mbetur tani vetëm dy murgesha fillestare dhe një 80-vjeçare.

FOTO E DITES



Dhjetëra persona kanë humbur jetën dhe mbi 600 janë lënduar nga disa tërmete të fuqishme që kanë goditur të martën Shqipërinë.

E jashtëzakonshme

Një grua vjedh tetë palë xhinse

Një grua ka arritur që të vjedhë tetë palë xhinse në një dyqan rrobash në një mënyrë të veçantë. Gruaja tejet elegante i veshi pantallonat që të tetat, njëra sipër tjetrës. Por ajo u zbulua nga sigurimi i dyqanit përmes kamerave. Kështu ajo detyrohet që t'i heqë dhe t'i kthejë që të gjitha mbrapsht. Pamjet e kësaj vjedhje të pazakontë janë bërë virale në rrjetet sociale.



BARSOLETA E DITËS



Njëri pyet kolegun polic:

- Çfarë ke? Të ka ndodhur gjë?
- Edhe po më pyet a? Nesër kam test të gjakut e nuk kam mësuar asgjë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI
Perceptimi juaj se dikush ju ka

mashtuar në një çështje pune do të rezultojë i vërtetë.



DEMI
Po ndiqni një informacion të dhënë

nga një person që nuk e njihni dhe aq mirë. Do të rezultojë i saktë.



BINJAKËT
Gjërat janë ashtu siç keni pritur

dhe kjo gjë ju ka sjell një lloj relaksimi që po ju pëlqen.



GAFORRJA
Jeta sentimentale është në

kulmin e saj dhe po prisni ta finalizoni me diçka më të rëndësishme.



LUANI
Shoqëria e mirë dhe miqtë do të

jenë ata që sot do të përkujdesen për t'ju bërë qejfin. Ndiheni mjaft të përkëdhelur.



IRGJËRESHA
Partneri ka vendosur t'ju japë një

lajm surpriz. Nuk do ta prisni aq mirë sa mendohej.



PESHORJA
Nëse keni marrë vendime

që s'i keni konsultuar më parë me të tjerët, duhet t'i merrni përsipër edhe përgjegjësitë nëse rezultojnë të gabuara.



AKREPI
Jeni mjaft të favorizuar nga yjet sot

dhe çdo iniciativë e juaja do të vlerësohet. Merrni me seriozitet lidhjen sentimentale.



SHIGJETARI
Jeni karaktere impulsive dhe sot do

ta vërtetoni këtë gjë. Një situatë stresante do të komplikohet me shumë nga ju.



BRICJAPI
Natyra juaj e qetë ka bërë që

persona rreth jush të fillojnë të tregohen. Keni kujdes nga këta persona.



UJORI
Shpirti liberal dhe aventuresk do të triumfojë sot

dhe ju do të jeni të rrethuar me persona që duan t'i provojnë të njëjtat përvoja.



PESHQIT
Keni kompensuar kohën e

humbur dhe sot do të jeni pranë personave që ju duan. Po e shijoni çdo çast.

Libër dëshmi për të burgosurit politikë shqiptarë në Jugosllavi (1989)

(Prof. dr. Sadik Mehmetit dhe prof. dr. Hysen Matoshi, "Të burgosurit politikë shqiptarë në Jugosllavi (1989) sipas dokumenteve sekrete të Ministrisë Federative të Drejtësisë dhe të Administratës", botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019)



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Të nderuar autor të librit prof. dr. Hysen Matoshi dhe prof. dr. Sadik Mehmeti,

Të nderuar veteranë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare,

Të nderuar të pranishëm,

Që në fillim dua të them se gjatë punës sime shkencore shumëvjeçare që kam bërë për hartimin e librit tim "Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1989", më ka rënë të hulumtoj, shfletoj dhe të studioj qindra e mijëra dokumente për të burgosurit politikë shqiptarë të cilat katërçipërisht dëshmojnë urrejtjen e pashembullt të pushtetit jugosllav, respektivisht serb ndaj shqiptarëve.

Andaj, edhe sot, kur po bëjmë promovimin e këtij libri dokument, është e njëjta gjë, se edhe me këtë dokument vërehet po e njëjta urrejtje shekullore e trashëguar dekadë pas dekadë. E këto dokumente dhe këto ngjarje edhe sot nuk të lënë që të jesh indiferent dhe në të detyrojnë të revoltoshesh, të rebelohesh, të mobilizohesh, për të rezistuar para së keqes dhe të mësohemi që kurrë më, ama bash kurrë, mos të harrojmë të kaluarën, për të mos u përsëritur jo vetëm tek ne, por askund në botë.

Të nderuar të pranishëm,

Sot kemi kënaqësinë që jemi mbledhur këtu, në një promovim pak sa më të veçantë, sepse bëhet fjalë për një botim me vetëm një dokument, por që ai dokument është mjaft voluminoz dhe ka 339 faqe, në të cilat trajtohet një nga periudhat më të bujshme, më të lavdishme dhe më të dhembshme të historisë së Kosovës në fund të shekullit XX, me titull "Të burgosurit politikë shqiptarë në Jugosllavi (1989)", përgatitur nga z. Sadik Mehmeti dhe Hysen Matoshi, punonjës shkencorë të Institutit Albanologjik, këtu në Prishtinë.

Dhe, ky dokument "Pasqyrë e personave të dënuar për të ashtuquajturin kriminalitet politik të cilët gjenden në burgje për vuajtje të dënimit", lindi falë presionit të madh të bashkësisë ndërkombëtare, veçmas të organizatës prestigjioze për

mbrojtjen e të drejtave të njeriut Amnesty International, Beograd, tetor 1989 dhe ishte klasifikuar si "Tepër sekret".

Sipas dokumentit, të nderuar të pranishëm, ofrohen të dhëna për 277 të burgosur politikë, nga të cilët, si gjithmonë, shqiptarët ishin shumicë në burgje, me gjithsej 245 veta, me emër e mbiemër (por në këtë rast nuk do t'i përmendim emrat e tyre, ngase janë shumë dhe se emrat e të gjithëve janë të shënuar në libër) ose thënë në përqindje, mbi 89 për qind e të gjithë të dënuarve politikë ishin shqiptarë.

Shtrohet pyetja nga çdo njeri që, vërtet është njeri, kush i burgosi këta atdhetarë?! E përgjigja nuk është larg! Nuk është e panjohur! Nuk është e pa ditur, nuk është enigmatike. Vetëm duhet lexuar dokumentin që e kemi në këtë libër nga autorët: Sadik Mehmeti e Hysen Matoshi, dhe aty do të gjejmë shumë të dhëna, shumë

dëshmi dhe shumë, e shumë mallkime nga vetë historia.

Sipas parathënies së dokumentit, thuhej se "i tërë dokumenti është hartuar në bazë të të dhënave dhe të materialeve të ministrive republikane dhe krahinore, kompetente për çështje të gjyqësisë, por këtu nuk mungojnë as raporti i Ministrisë Federative të Mbrojtjes Popullore, ku janë paraqitur të dhënat mbi këtë kategori të të burgosurve që ishin në varësi të saj.

Dhe, sa herë që flas për ndonjë libër, që temë trajtimi ka atdhetarët tanë, pa dashur më kujtohet thënia, ndoshta edhe më e mira, për librin se: "Libri është më i vlershëm se të gjitha përmendoret, sepse ai vetë ngrë përmendore për ta". E kjo thënie gjën shprehjen më të mirë për librin që përurohet sot. Autorët, nëpërmes këtij libri, u ngrënë përmendore të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë në

Kosovë, një përmendore të madhe atyre (të vdekurve, a të gjallë), që kaluan nëpër burgje vitet më të mira të jetës e që me shifra thuhet se, për 245 shqiptarë u shqiptuan 2 000 vjet burg. E këto vite nuk janë gabim, as në të shprehur, as në të shkruar, autorët flasin në bazë të fakteve.

Të nderuar,

Hulumtimi, argumentimi, faktimi, mbamendja dhe ruajtja e kujtesës janë cilësi e historisë dhe e historianit. Andaj detyrë e historianit është që ta kultivojë këtë cilësi, që me këtë rast dëshmohet se autorët në mënyrën më autentike kanë sjellë të përkthyer, dokumentin voluminoz, që mban vulën e topsekretit shtetëror.

Po të thuhej fjala e fundit e para, do të mund të pohohej se autorët na kanë dhuruar librin jo që e kanë dëshiruar autorët, por që e ka porositur koha, koha nëpër të cilën kanë kaluar shqip-


tarët, koha që vazhdon të bëjë porosi të reja-për ta ruajtur dhe për ta mbrojtur palcën kurrizore të popullit që po rritet si numër e po kërcënohet të tkurret si komb. Hiq më larg se këtyre ditëve shqiptarët sërish thirrën nga Gjykata Speciale në Hagë, që të dëshmojnë apo që të akuzohen pse bënë luftë të drejtë në mbrojtje të lirisë, të jetës dhe vendit të tyre. Historia e shqiptarëve nuk është tjetër veçse histori e luftërave për liri dhe pavarësi. Mirëpo, siç vërehet, politika antishqiptare "mbajti ndezur zjarrin e luftës për liri e të drejta politike dhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare".

Duke marrë parasysh faktin se një literaturë e këtillë apo e ngjashme ka munguar deri më tani, komuniteti shkencor e mirëpret botimin e këtij vëllimi me dokumente arkivore, duke e vlerësuar lart këtë iniciativë dhe njëkohësisht duke shpresuar se i njëjti në të ardhmen do të bëhet pjesë përbërëse e realizimit të projekteve të cilat do ta trajtojnë historinë më të re të Kosovës nga ana e institucioneve shkencore. E themi këtë, pasi dokumenti të cilën na e sjellin prof. dr. Sadik Mehmeti dhe prof. dr. Hysen Matoshi janë të një rëndësie të veçantë, nëse kemi parasysh angazhimin, veprimtarinë dhe qëndresën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe vazhdimin e Luftës për çlirimin e vendit.

Dhe, të nderuar të pranishëm, Pikërisht, për këtë qëndresë, për këto ideale, për këto sakrifica të të burgosurve politikë shqiptarë shkruhet në këtë vëllim dokumentesh dhe këta veprimtarë e të burgosur politikë, ndonëse në kushte e rrethana të vështira, arritën ta lëviznin historinë. Prandaj, koha jo rrallë shkakton stuhi dhe në këto stuhi ajo nuk matet vetëm me tragjedi, por edhe me njerëz të guximit, të trimërisë dhe të vetëbesimit në fitore. Këtë e dëshmuar të burgosurit politikë e më vonë edhe luftëtarë të UÇK-së, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, i cili u bë shpirti, zemra dhe drita e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Dhe krejt në fund, autorëve iu dëshiroi shëndet dhe shumë suksese në të gjitha fushat e jetës.

Ju falënderoj për vëmendje!

(Fjalë e mbajtur në promovimin e librit të prof. dr. Sadik Mehmetit dhe prof. dr. Hysen Matoshit, "Të burgosurit politikë shqiptarë në Jugosllavi (1989)", Prishtinë 25 nëntor 2019)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Sportistët solidarizohen me Shqipërinë

Sportistët e Kosovës, me vendbanim anembanë botës, janë solidarizuar me Shqipërinë pas tragjedisë që la shumë të vdekur, në mesin e tyre edhe dy shqiptarë nga Kosova. Po ashtu, edhe klube dhe institucione sportive evropiane janë solidarizuar me shtetin shqiptar në këto çaste të vështira



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Shqipëria është goditur nga tërmeti i fuqishëm me magnitudë 6.4 ballë të shkallës Rihter në orën 3:55 të mëngjesit të ditës së martë. Përveç dëmeve të shumta materiale, ka edhe njerëz të vdekur. Në mesin e tyre dy janë të vëllezër nga qyteti i Gjilanit. Pas kësaj tragjedie me shtetin shqiptar është solidarizuar komuniteti sportiv në Kosovë dhe më gjerë. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka thënë se populli i Kosovës solidarizohet me vëllezërit dhe motrat nga Shqipëria. "Në emrin tim, të KE të FFK-së dhe tërë komunitetit të futbollit në Kosovë u shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjeve të viktimave dhe bashkëndiejmë me të në këto çaste të vështira. FFK-ja solidarizohet me FSHF-në, klubet e futbollit dhe tërë kombin shqip-

tar në këtë situatë emergjente dhe do të jetë e gatshme t'i ndihmojë me të gjitha kapacitetet vëllezërit dhe motrat tona në Shqipëri. Lusim Zotin që kjo gjendje të tejkalohet sa më shpejt, njëherësh shprehim gatishmërinë dhe solidaritetin tonë të plotë me popullin dhe institucionet e shtetit shqiptar, kurse për të gjithë të lënduarit urojmë shërim sa më të shpejtë!", është thënë në letërën e kryetarit Agim Ademi. Pas kësaj tragjedie ka reaguar edhe grupi i tifozëve të Kosovës, "Dardanët": "Lutemi për shpirtin e viktimave, për familjet e tyre dhe për të lënduarit nga kjo tragjedi e rëndë. #MetyShqipëri". Ndërsa në shërbim të të prekurve nga kjo tragjedi janë vënë "Tifozat Kuq e Zi", të cilët nëpërmjet një njoftimi kanë bërë me dije se janë gati ta japin ndihmën e tyre vullnetare qoftë si pjesë e ushtrisë, Kryqit të Kuq, apo organizatave të tjera simotra që ndihmojnë

njerëzit në nevojë. Duarkryq nuk kanë qëndruar edhe tifozët nga Prishtina "Plisat", të cilët kanë bërë një organizim me grumbullimin e veshmbathjeve dhe gjërave ushqimore dhe të martën pasdite i kanë dërguar në Shqipëri. Krahas këtyre, edhe tifozëritë e tjera kanë shprehur vullnetin që t'u ndalin në ndihmë personave të prekur nga tërmeti, gjithashtu edhe futbollistët e njohur shqiptarë që luajnë në ligat evropiane, si Milot Rashica, Vedat Muriqi, Mërgim Mavraj, Shkodran Mustafi, Samir Ujkani, Mërgim Vojvoda dhe shumë e shumë futbollistë e sportistë të tjerë. Ndërsa trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka thënë se të gjithë duhet të luten që të ketë sa më pak viktime nga tragjedia në shtetin shqiptar. "Të lutemi për Shqipërinë tonë. Për sa më pak viktime nga tërmetet që goditën sot në mëngjes. Me mendje dhe zemër jemi afër familjeve që sot humbën më të dashurit e tyre. Të solidarizohemi për të ndihmuar aty ku ka nevojë, që së bashku t'i përballojmë pasojat e tërmetit fatal", ka thënë Kuka. Ndërsa ish-kapiteni i Shqipërisë në futboll, Lorik Cana, ka shkruar: "Zoti qoftë me ne!" Edhe

boksieri i famshëm shqiptar, Haxhi Krasniqi, i është bashkuar listës së sportistëve që janë solidarizuar me shtetin shqiptar. "Nuk jemi mirë ne kur nuk është mirë Shqipëria. T'i lutemi Zotit", ka shkruar boksieri Krasniqi, duke ia përcjellë këtij postimi edhe një fotografi, ku shkruan në gjuhën angleze: "Lutemi për nënën Shqipëri".

UEFA: Jemi të pikëlluar nga tërmeti në Shqipëri

Për tërmetin në Shqipëri ka reaguar edhe shtëpia e futbollit evropian, UEFA. Përmes një postimi në "Twitter", UEFA ka shkruar se janë të trishtuar nga tërmeti i sotëm në Shqipëri. "Të gjithë në familjen e futbollit evropian janë thellësisht të pikëlluar nga tërmeti i sotëm në Shqipëri. Mendimet tona janë me familjet dhe miqtë e viktimave dhe të gjithë ata që janë prekur nga kjo", thuhet në reagimin e UEFA-s.

AC Milan: Lutjet tona janë me vëllezërit dhe motrat në Shqipëri

Edhe skuadra e famshme ital-

iane AC Milan është solidarizuar me Shqipërinë për tërmetin që ndodhi në orët e para të mëngjesit të së martës. "Në këto çaste tragjike lutjet tona janë me vëllezërit dhe motrat në Shqipëri nga tërmeti katastrofal. Qëndroni të fortë", ka shkruar Milani në llogarinë e vet në "Twitter".

Tare: Do të bëj gjithçka që është e mundur për ta ndihmuar popullin tim

Drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, ka reaguar pas tërmetit të fuqishëm që ka goditur Shqipërinë, duke thënë se do të bëjë gjithçka të mundur për t'i ndihmuar bashkëkombësit. "Është një tragjedi që më ka prekur shumë mua dhe familjen time. Tragjedi e madhe. Duket se numri i viktimave është duke shkuar në rritje. Uroj me gjithë zemër të jetë e kundërta", ka thënë Tare për mediat italiane. Tare, po ashtu, ka shfaqur gatishmëri për të ofruar ndihmë. "Do të bëj gjithçka që është e mundur për ta ndihmuar popullin tim", ka theksuar ish-sulmuesi i kombëtares shqiptare.



Shtyhen ndeshjet e Kupës

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar klubet dhe opinionin se ndeshjet e rrethit të dytë të Digitalb Kupës së Kosovës në fut-

boll, të parapara të zhvillohen të mërkurën, janë shtyrë. "Ky vendim është marrë nga Komisioni i Garave, duke pasur parasysh se presidenti i

vendit, Hashim Thaçi, ditën e mërkurë e ka shpallur ditë të zisë, në shenjë respekti për viktimat e tërmetit të fuqishëm që goditi Shqipërinë në orët e

hershme të mëngjesit të sotëm. Ndeshjet e rrethit të dytë do të zhvillohen, të enjten, më 28 nëntor", thuhet në njoftimin e FFK-së.



Rusia rrezikon ta humbë organizimin e ndeshjeve të 'Euro 2020'

MOSKË, 26 NËNTOR - Rusia rrezikon t'i humbë ndeshjet e "Euro 2020" që ishte planifikuar t'i organizojë, pasi Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA) ka rekomanduar që Rusia të pezullohet nga të gjitha ngjarjet sportive për katër vjet. Rusia mund të pezullohet edhe

nga Lojërat Olimpikë të vitit të ardhshëm në Tokio pasi ishte përjashtuar nga Lojërat Dimërore të vitit 2018, por edhe nga gara të tjera të mëdha sportive. Komiteti për rishikimin e përputhshmërisë në WADA e publikoi një raport të fundit ku akuzon Agjencisë

Ruse të Anti-Dopingut për shkelje të rregullave dhe parregullsi në të dhënat për anti-doping. Ndër propozimet e bëra në këtë raport është që Rusisë t'i hiqet e drejta e organizimit të ndeshjeve të "Euro 2020", përveç nëse kjo është praktikisht dhe ligjrisht

e pamundur. St. Petersburgu, qyteti i dytë më i madh në Rusi, është planifikuar të jetë nikoqir i disa ndeshjeve të "Euro 2020", përfshirë njëjërën çerekfinale dhe disa ndeshje të fazës së grupeve. Komiteti Ekzekutiv i WADA-s do t'i shqyrtojë rekomandimet dhe



do ta marrë vendimin përfundimtar në një takim në Paris më 9 dhjetor.

Liverpooli për hakmarrje dhe kualifikimin ndaj Napolit



LIVERPOOL, 26 NËNTOR - Kampioni në fuqi i Evropës, Liverpool, është gati për përballjen me Napoli në kuadër të Ligës së Kampioneve. "Reds" po synon t'i mposhtë italianët e drejtuar nga Carlo Ancelotti dhe në këtë mënyrë t'u hakmerret për humbjen që i kishin shkaktuar në përballjen e parë, po ashtu edhe ta sigurojnë kualifikimin tutje. Liverpooli po tregon formë të mirë, pasi nga 24 ndeshjet e fundit i ka fituar 22 dhe muajin tjetër do të luajë në finale të Kupës së Botës për klube në Katar. Në anën tjetër, edhe Napoli do të kërkojë fitore në këtë ndeshje në mënyrë që ta vazhdojë rrugëtimin në garën më të fortë në futboll si lider i grupit. Në skuadrën e Liverpoolit vetëm Matip nuk do të luajë, kurse Salah, Robertson dhe Shaqiri janë të gatshëm. Në formacionin e Ancelottit në

dyshim janë sulmuesit Milik dhe Insigne, kurse Kevin Malcuit mungon për një kohë të gjatë. Liverpooli është në vend të parë ka nëntë pikë të grumbulluara, derisa Napoli është një pozitë më poshtë me një pikë më pak. Ndeshje interesante do të zhvillohen edhe në grupin D, ku Barcelona e pret Borussia Dortmundin. Leo Messi me shokë me tri pikë ndaj gjermanëve e sigurojnë pozitën e partë në grup, kurse Dortmundi do të mundohet që të mos humbë në "Camp Nou" dhe ta ruajë pozitën e dytë në grup. Interi shpreson në fitore kundër Slavias dhe të një humbje e Dortmundit për t'i ruajtur shpresat për kualifikimin në rrethin tjetër. Grupi më delikat është Grupi H, pasi tri skuadra kanë nga shtatë pikë. Ajaxi është më afër kualifikimit, pasi luan ndaj skuadrës së fundit në tabelë,

GRUPI E		
21:00 Genk - Salzburg		
21:00 Liverpool - Napoli		
Tabela		
1. Liverpool	4	PIKË 9
2. Napoli	4	8
3. Salzburgu	4	4
4. Genk	4	1
GRUPI F		
21:00 Barcelona - Borussia Dortmund		
21:00 Slavia P. - Inter		
Tabela		
1. Barcelona	4	PIKË 8
2. Dortmund	4	7
3. Inter	4	4
4. Slavia Prague	4	2
GRUPI G		
18:55 Zenit - Lyon		
21:00 Leipzig - Benfica		
Tabela		
1. Leipzig	4	PIKË 9
2. Lyon	4	7
3. Zeniti	4	4
4. Benfica	4	3
GRUPI H		
18:55 Valencia - Chelsea		
21:00 Lille - Ajax		
Tabela		
1. Ajaxi	4	PIKË 7
2. Chelsea	4	7
3. Valencia	4	7
4. Lille	4	1

Lille që këtë edicion nuk regjistroi rezultate të mira në Ligën e Kampioneve. Ndërsa kualifikimin do ta diskutojnë edhe Valencia dhe Chelsea.

Lakersat dhe Milwaukee nuk kanë të ndalur në NBA

SAN ANTONIO, 26 NËNTOR - Në NBA është momenti i Los Angeles Lakersit, pasi kjo skuadër ka regjistruar shtatë fitoret radhazi. "Viktima" e fundit e LeBron Jamesit dhe Anthony Davisit me shokë ishte San Antonio Spurs që u mposhtë brenda në "AT&T Center" nga Lakersi me rezultatin 104-114. Me 33 pikë, 3 rebounde dhe 14 asistime mbreti James ishte ai që udhëhoqi skuadrën e Frank Vogelit drejt fitores së radhës, ndërkohë që paraqitje të mirë bëri edhe Anthony Davis i cili koleksionoi 19 pikë, 12 rebounde dhe 6 asistime. San Antonio në krahun tjetër që është në krizë të thellë rezultatesh, pësoi humbjen



e 9-të në 10 ndeshjet e fundit. Atij nuk i mjaftuan 54 pikët e realizuara nga dyshja Aldridge-DeRozan. Nuk di më të ndalet as Milwaukee Bucks që, gjithashtu, mori fitoren e 7-të radhazi pasi mposhti në Wisconsin 122-118 Utah Jazzin në një ndeshje ku diferencën e bëri i përhershmi Giannis Antetokounmpo, autor i 50 pikëve, ndërsa shtoi edhe 14 rebounde e 6 asistime. Kjo ishte fitorja e 14 në 17 takime për Bucksin i cili kryeson konferencën

e Lindjes. Një sukses me peshë mori edhe kampioni në fuqi i NBA-së, Toronto Raptors, që mposhti 101-96 Philadelphia 76ers falë 49 pikëve të realizuara nga dyshja Siakam-VanVleet. Nuk di të ngrëjë kokë Golden State që ka filluar ta "shikojë" me dylbi që tani fazën "play-off", pasi pësoi humbjen e 15-të në 18 ndeshje. Warriorsi u mposhtë në "Oracle Arena" me rezultatin e ngushtë 97-100 nga Oklahoma City Thunder.

SHKURT

Klopp: Van Dijk e meriton 'Topin e Artë'

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se qendërmbrojtësi Virgil van Dijk e meriton "Topin e Artë". Futbollisti holandez së bashku me Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldo janë tre kandidatët kryesorë për "Topin e Artë" këtë sezon. Tekniku gjerman ka thënë se Van Dijk e meriton pasi ka qenë lojtari më i mirë në sezonin e kaluar. "Nëse 'Topin e Artë' e meriton lojtari më i mirë i gjeneratës, atëherë duhet t'ia japësh Lionel Messit. Por, nëse e meriton lojtari më i mirë në sezonin e kaluar, atëherë e meriton Virgil van Dijk. Nuk e di si funksionon, mirëpo do të shohim", deklaroi ai. Liverpooli po vazhdon në formën e duhur dhe ende nuk di për humbje në kampionatin anglez.

Messi, Neymarit: Dua që të rikthehesh te Barcelona

Neymari ishte shumë afër rikthimit te Barcelona në afatin kalimtar të verës, por marrëveshja me klubin e lojtarit nuk u arrit. "France Football" ka zbuluar se Leo Messi e ka kontaktuar Neymarin pas ndeshjes së humbur me Liverpoolin në sezonin e kaluar në gjysmëfinalen e Ligës së Kampioneve. Pikërisht në telefonatën me dy personave, argjentinasin i ka kërkuar sulmuesit të PSG-së të rikthehet te Barcelona. "Unë dëshiroj që ti të rikthehesh këtu. Vetëm së bashku mund ta fitojmë Ligën e Kampioneve. Pas dy sezonesh unë do të largohem dhe ti do të jesh i vetëm, pra do ta marrësh vendin tim", ishin fjalët e Messit për Neymarin.

Mourinho i dëshiron Fernandesin dhe Diasin


Trajneri i Tottenham Hotspurit, Jose Mourinho, raportohet se dëshiron të nënshkruajë me Bruno Fernandes dhe Ruben Dias, për të cilët ka kërkuar edhe ndihmën e agentit Jorge Mendes. Të dy lojtarët kanë shkëlqyer në klubet e tyre përkatëse dhe Portugalinë gjatë këtij viti dhe janë pjesë e listës së dëshirave të shumë skuadrave. Sipas "90min.com", strategu portugez është vënë pas këtyre dy sulmuesve që dëshiron t'i transferojë në afatin kalimtar të verës.

Nëse qëndron Emery, largohen Aubameyang dhe Lacazette

Skuadra e Arsenalit po kalon nëpër një periudhë të vështirë në këtë sezon pasi, përveç rezultateve negative, kjo skuadër rrezikon të braktiset nga disa futbollistë. Sipas "Daily Mail", Pierre-Emerick Aubameyang dhe Alexander Lacazette janë të gatshëm të largohen nga "The Gunners" qysh në fund të këtij sezoni. Dyshja e sulmit është e pakënaqur me trajnerin Unai Emeryn dhe nëse spanjollit qëndron, atëherë sulmuesit do të largohen.

Alcaceri mungon ndaj Barçës

Borussia Dortmund do të luajë ndaj Barcelonës në "Camp Nou" të mërkurën në mbrëmje, një sfidë që mund të vendosë shumë për sa iu përket fateve të kualifikimit. Në kuadër të takimit, verdhezinjtë kanë marrë një lajm mjaft të hidhur teksa Paco Alcacer nuk ia ka dalë të rikuperohet në kohë për të qenë i gatshëm për trajnerin Favre.



Autor: GAZMEND MORINA						SHARRËZ (shq.)	TINGULL QË FORMOHET	QYTEZË NË SHQIPËRI	ILAZ KODRA	TRAJNERI PREKAZI	BASHKËT.	LLOGORE	LIGJ, KANUN (vjet.)	QILIM QË SHTROHET NË NJË ANË TË OXHAKUT	QË KA TË BËJË ME NERVAT	ISMET TOTO	
HEROI NË FOTO																	
NJËRA NDËR TRI GJINITË KRYESORE TË KRIJIMTARISË LETRARE											VJERSHË LIRIKE PREJ 14 VARGJESH POROSI E FUNDIT						
REGJISORI HOLIVUDIAN ... BURTON									ISH FUTBOLLISTI VATA BASHKËT							KOHA KUR NIS TË ZBARDHË DITA	
INSTITUCION I LARTË SHKENCOR													AKTORJA LONGORIA DRU BISHTAJOR I VENDEVE TË NGROHTA				
SHEGË QË U PËRKËT POLEVE, I POLIT									THEMBRA E KËPUCËS ISH "MISS ALBANIA" GENTIANA					OLIVIA GARDEN KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKAN (shqip.)			
→											SMIRA QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP						
SELEN								GJERMAN I VJETËR PËREMËR PRONOR							BASHKËT. MUZIKANTI KRASNIQI		
EPOKA E RE	FLETË LETRE PËR DUHAN	KËNGËTARJA JONË MARKU	RI FILLUAR	AKTORJA AMERIKANE ... FARIS	FJJE E HOLLË PAMBUKU	ZANORE IVREA		I PESHOJ VAJ KUZHINE QË PRODDHOHET NË SHQIPËRI					KËNGËTARJA MIRIAM BASHKËT.				
MJEKIM I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME VETËM ME BARNA											CA ISH FUTBOLLISTI PORTUGJEZ ... COSTA					AUTOMOBIL QË SHËRMBEN PËR TË MBARTUR MALLRA	
PARAGRAF								ISH FUTBOLLISTI KOLA VITI I RI KINEZ (pashq.)						QË KA TË BËJË ME ETIKËN QYTET I MADH NË GJERMANI			
FOLTORJA								TANTAL, INTENSITET KASNEC						MA JEP IVAN DIXON			
NJË KONTINENT								EMËRTIM I NJË NOCIONI JON ME NGARKESË POZITIVE			NANTES KËNGËTARJA ELSA	REGJISORJA SHQIPTARE ... ELEZI LETONIA (shk.)				MALMO PORT DETAR	
KAPELË BURRASH ME STREHË									KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM SHPËRDORIM (sh.shq.)				JETA E QETË NË ÇFARË SASIE				
EPOKA E RE	KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP TË MADH PEMË E VENDEVE TROPIKALE					DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EIDE DJALLEZORE				STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK FRYMA			AMERICANS INDIAN OPPORTUNITY NJË E PANJ-OHUR NË MATEMATIKË				
KËNGËTARI ASLLANI								BLETËRRITËSI PJESE E FORTË E BUKËS (sh.shq.)							DY BASHKË-TINGËLLORE DETYRA E AKTORIT		
ALBERTO TOMBA								I LYER ME LLAK TITAN			REPER I NJOHUR AMERIKAN			VEZË SHUMË TË VOGLA TË PESHQVE HARAÇI			IKACAK, IKANAK (bised.)
PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË								LUAJ NDESHJE		AMPER, ERBIUM				KËNGËTARJA ... MALAJ AKTORJA AMERIKANE ZELLWEGER			
ZANORE								KLUB FUTBOLLI NË ITALI (shq.) SOLISTJA BOKA		ARBEN MALAJ	AKTORJA E NJOHUR ... STRIP (shqip.) TROYES					KRUJA QYTETI FRANCEZ I FILMIT	
NAIM OSMANI								INSTITUTE APPLIED LEARNING	JO TEMATIKE, ATEMORE (bised.)					SHOVA, ECA (bised.) ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. origj.)			
SOLISTJA ... FARA								MË ZË GJUMI DUKE NDENJUR PRODUKT ZJARRI			NËNNDARJA E NJË LIGJI BELGJIKJA, AUSTRIA				ARTIOLA TOSKA		
EPOKA E RE	TRAJNERI LUSHTAKU BASHKËT.					BASHKËT. TOTENHAM		I SHËMTUAR (krah.) BASHKËT.							NAIM ABAZI BASHKËT.		
KALESË (sh.shq.)									INFERMIERE QË KUJDESOHET PËR GRATË GJATË BARRËS							KALLI MISRI QË VARET NË TRARËT E SHTËPISË PËR TË THAR	

Njoftimi për shprehje të interesit
 Emri i shkollës: **"Osman Mani"**
 Komuna: **Shtërpçë**
 Data: **22.11.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/103- ESIP/SDG/103-	Aktivitetet garues me nxënës dhe Botimi i

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkollës "Osman Mani" – Firajë, Shtërpçë**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
 - Aktivitetet garues me nxënës dhe Botimi i revistës.**
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: : **Shkolles "Osman Mani", Firajë, Shtërpçë, më së largu deri më 30.11.2019.**
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Ganimete Xhemajli
Telefoni: 044380029
E-maili: ganimetexhemajli@hotmail.com

Njoftim për shprehje të interesit
 Emri i shkollës: **"Elena Gjika"**
 Komuna: **Skenderaj**
 Data: **25.11.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/108-CS/1.3	Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë

